REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 167/17
Data/Datum 02.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **Qendra Klinike Universitare e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **701-16-097-211**

Sa i përket tenderit për: **Servisimi dhe mirembajtja e rregullt e paisjeve radiologjike - Rivleresim**

**Vetem per Llot 1,2,3,6 dhe 7**

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

*LEDI MED SHPK*

*28 Nentori, SU 1/5*

*Prishtine* *10000*

[redacted]

*Arben Alushaj*

[redacted]

*02/06/2017* _____:

LEDI MED SHPK

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____
*(Emri i avokatit)*

_____
*(Adresa e plotë)*

_____ _____
*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____
*(Adresa elektronike)*

_____ _____
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*Njoftimi për kontrate është publikuar në faqen e KRPP-së, me datë 06/09/2016, pastaj është bërë edhe shtyerje e afatit për dorëzim të ofertave, hapja e ofertave është bërë me datë 03/10/2016, kriter për dhënie të kontratës,* ***Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.*** *Me vendim te OSHP-së, Lënda është kthyer në* ***Rivlerësim****, vendimi nr. 53/17 datë 12.04.2017.*

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [x] **Jo** [ ]

*Hapja e tendereve ka shkuar në mënyrë të rregullt, nuk ka pasur vërejtje.*

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

*Ne si OE kemi bere kerkese per rishqyrtim me date* ***23/05/2017****, ku ne nuk jemi pajtuar me vendimin e AK - QKUK, ku si rrjedhoj, ne jemi eliminuar padrejtesisht nga ky aktivitet i prokurimit.*
*Me date 29/03/2017 kemi pranuar vendimin e rishqyrtimit te kerkesës sonë, vendim i cili përsëri na eliminon nga aktiviteti i prokurimit, si ofertues të papërgjegjshëm, edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe kemi pasur çmim me te ulet nga te gjithë ofertuesit tjerë.*

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

*Autoriteti Kontraktues i lartëcekur gjatë vleresimit te ketij aktiviteti te prokurimit ka bërë shkelje te ketyre nenevd edhe dispozoitave ligjore te LPP-së:*

- *Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*
- *Neni 7, Barazia në trajtim/Jo-diskriminim;*
- *Neni 41- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve i udhezuesit operativ per prokurim publik*
- *Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve;*
- *Neni 72 i LPP-së, për sqarime shtesë;*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*